

# Mësim praktik (Metoda e përpunimit) II

## 2. Faza e përpunimit

Gjatë fazës së përpunimit nxënësi udhëhiqet me anë të impulseve dhe pyetjeve. Së pari pyetet se si do ta kryente ai këtë punë. Para së të fillojë zbatimin, nxënësi duhet të provojë hapat e punës pa ngjyrë. Me këtë rast duhet të veçohet përpunimi i këtyre pikave:

- Mbatja e fuqës: Nxënësi duhet të mbajë fuqën njëherë si një reketë (tenisi) dhe një herë si laps, në mënyrë që të mund ta ndjejë dallimin. Së fundi me rëndësi është që fuqja të mbahet sikurse lapsi në dorë, në mënyrë që gjatë ngjyrosjes të përdorë ndieshmërinë e hollësishme të mollëzave të gishtërinjëve.
- Pasja parasysh e dejzimeve të drurit: Gjatë bartjes së ngjyrosjes me anë të fuqës të ecet pas në drejtim të dejzimit, gjatë shpërndarjes së ngjyrës në drejtim të kundërt me dejzime. Me këtë rast nxënësi duhet paraprakisht të përcaktojë drejtimin e dejzimeve respektivisht atë të drurit, në mënyrë që të vlerësojmë se a i ka kuptuar ai këto terme. Përveç kësaj nxënësi duhet të kuptojë se si e ka bërë bartjen e fuqës mbi sipërfaqe.

Përpunimi i veprimit bëhet në bazë të parimit të ndarjes kohore të punës. Të gjithë hapat e punës do të zbatohen nga vetë nxënësi. Me këtë rast ai duhet vetë të përshkruajë se si po vepron dhe të arsyetojë veprimin e tillë. Nëse nxënësi ka vështirësi në ndonjërin hap të punës, ai do të përkrahet me anë të dhënies së impulseve të përshtatshme. Vetëm nëse nuk ka mundësi tjetër, bëhet demonstrimi i një pjese.

Me rëndësi është edhe këshilla, se gjatë përpunimit, rol më të rëndësishëm ka një zbatim i kujdesshëm i punës se sa një punë e kryer shpejt. Natyrisht se me këtë rast duhet respektuar kohën e dhënë për ngjyrë.

Për fillimin e punës aplikohen masat e lartpërmendura të sigurisë.

## Faza e kontrollimit

Përmbajtja mësimore	Këshillat meodike
Kontrollimi i të pamurit, përshtypja optike e sipërfaqes së ngjyrosur.	Nxënësi duhet të shënojë se si e vlerëson ai vetë punën e tij. Ai duhet të sqarojë se çka ka bërë mirë e çka jo, respektivisht çka do të kishte mundur të përmirësonte.
Kontrollimi i nuancës së ngjyrës bazuar në provën e ngjyrës	Nxënësi udhëzohet që sipërfaqën e ngjyrosur ta krahasojë me provën e ngjyrës dhe të vlerësoj se a është në rregull nuanca e ngjyrës.
Kontrollimi i të mësuarës	Nxënësi duhet edhe njëherë shkurtimisht të përmbledhë hapat kryesor të punës, në rast nevojë të pyetet se cilat masa të sigurisë duhet pasur kujdes, se çfarë enësh nuk guxojnë të përdoren dhe se çfarë duhet pasur kujdes gjatë krahasimit me provën e ngjyrës.
Reagimet nga ana e mësimeve	Të jipen këshilla, çka është pozitive e çka negative në punim; motivimi i nxënësit për ushtrime të mëtejme.

## Faza e ushtrimit

Nxënësit i ndahen detyra njëra pas tjetrës, në mënyrë që të thelloj teknikën e ngjyrosjes, p.sh. ngjyrosja e një sipërfaqe të drejtë. Të veçantat e detyrave të ushtrimit duhet përpunuar së bashku, para fillimit të fazave kalimtare.